



Ne baze te nenit 12, paragrafi 2, shkronja (d) lidhur me nenit 17, paragrafi 1, shkronja (b), të Ligjit Nr. 03/L-040, për Vetëqeverisjen Lokale, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28/2008”, e në mbështetje të nenit 5, paragrafi 1.2, pika 1.2.1 dhe nenit 6 paragrafi 1.2 pika 1.2.1 lidhur me nenin 10, paragrafi 2, pika 2.1, nenit 11 dhe nenit 15, të Ligjit Nr-04/L-174 për Planifikimin Hapësinor “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 30/2013” dhe Udhëzimit Administrativ (MMPH) Nr. 11/2015 mbi elementet dhe kërkesat themelore për hartimin, zbatimin dhe monitorimin e Planeve Zhvillimore Komunale, si dhe Udhëzimit Administrativ (MMPH) Nr. 08/2017 për normat teknike të planifikimit hapësinor dhe Vendimit për dhënien e pëlqimit për miratimin e Planit Zhvillimor Komunal të Suharekës-2021-2029 të datës 28.09.2021 nga Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, e konform neneve 15, 29, pika 2, te Statutit te Komunës se Suharekës, 01-Nr-8336, i datës 04.11.2008, Kuvendi i Komunës së Suharekës në mbledhjen e mbajtur me datën, 29.10.2021 miratoi këtë:

V E N D I M

Për miratimin e Planit Zhvillimor Komunal-2021-2029 (PZHK)

Neni 1

MIRATOHET- “Plani Zhvillimor Komunal” për Komunën e Suharekës për periudhën 8, (tetë) vjeçare **2021-2029** (në tekstin e mëtejme PZHK), si një dokument-plan multi-sektorial i cili përcakton caqet afatgjata të zhvillimit ekonomik, social dhe hapësinor duke përfshirë planin për zhvillimin e zonave urbane dhe rurale për tërë territorin e Komunës së Suharekës me sipërfaqe të përgjithshme prej 361km² ose 36,099.00 ha.

Neni 2

2.1 “Plani Zhvillimor Komunal i Suharekës-2021-2029” përcakton vizionin, parimet, objektivat dhe prioritetet e zhvillimit strategjik për tërë territorin e Komunës, mbi të cilat bazohet hartimi i Hartës Zonale të Komunës së Suharekës.

2.2 Pjesë përbërëse e këtij vendimi është “Plani Zhvillimor Komunal i Suharekës-2021-2029” i hartuar nga Drejtoria për urbanizëm dhe planifikim e Komunës së Suharekës, duke u bazuar në dispozita e Ligjit Nr-04/L-174 për planifikimin hapësinor “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 30/2013” dhe Udhëzimit Administrativ (MMPH) Nr. 11/2015 mbi elementet dhe kërkesat themelore për hartimin, zbatimin dhe monitorimin e Planeve Zhvillimore Komunale, si dhe Udhëzimit Administrativ (MMPH) Nr. 08/2017 për normat teknike të planifikimit hapësinor dhe i miratuar me vendimin Nr. 2785-2/21 të datës 28.09.2021 për dhënien e pëlqimit për “Planin Zhvillimor Komunal i Suharekës 2021-2029” nga Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës në Prishtinë.

2.3 “Plani Zhvillimor Komunal i Suharekës-2021-2029” përmban pjesën tekstuale dhe pjesën grafike, Raportin e vlerësimit strategjik mjedisor dhe Raportet e shqyrtimit publik dhe janë pjesë përbërëse të këtij vendimi.



Neni 3

Të gjitha Planet tjera komunale që nuk janë në kundërshtim me “Planin Zhvillimor Komunal të Suharekës për periudhën 2021-2029”, mbesin ne fuqi deri në miratimin e Hartës Zonale të Komunës së Suharekës.

Neni 4

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen të gjitha organet e Komunës së Suharekës, nën mbikëqyrjen e Kryetarit të Komunës.

Neni 5

Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës në Suharekë, ky vendim hyn në fuqi 15, ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81, të Ligjit mbi vetëqeverisjen lokale, Nr-03/L-040, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28/2008”, nenit 8, lidhur me nenin 9, të Rregullores, Nr. 10/2019, për procedurat e hartimit dhe publikimin e akteve të Komunave dhe pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose web-faqen zyrtare të Komunës.

Neni 6

Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi shfuqizohet vendimi me numër te protokollit 01-Nr-5821 të datës 05.03.2008 për miratimin e planit zhvillimor komunal 2007-2017.

KUVENDI KOMUNËS NË SUHAREKË

01-Nr-016-67691
Me datë 29.10.2021



Kryesuesi Kuvendit

Mr. Bexhet KUÇI